
AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
FREE CO SHPK

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'M' or 'H' shape above a more complex, cursive-like signature.

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFUIZUAR
FREE CO SHPK

NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë është "FREE CO" SHPK (në vijim e referuar si "Shoqëria").

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. "Abdi Toptani", Ndërtesa "Torre Drin", Kati 4, Ap. 10, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për të transferuar selinë e Shoqërisë në një vend tjetër. Organi i administrimit të Shoqërisë ka të drejtë të hapë dhe të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I AKTIVITETIT

- 4.1 Shoqëria ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj:
- 4.1.1 Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme si uji, gazi, nxehtësia, etj.;
- 4.1.2 Prodhimin, transmetimin, blerjen, shitjen, shkëmbimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, përfshirë aktivitetet e importit dhe eksportit të energjisë, produkteve dhe shërbimeve;
- 4.1.3 Aktivitetin e financimit, zotërimin e interesave dhe pjesëmarrjeve në shoqëri e sipërmarrje, administrimin, kërkimin dhe inovimin, këshillimin dhe asistencën në sektorin e energjisë në përgjithësi;
- 4.1.4 Këshillimin, hartimin e projekteve në lidhje me energjitë e rinovueshme, si edhe realizimin dhe më pas administrimin e këtyre investimeve, përfshirë ndërtimin dhe administrimin e hidrocentraleve ose e veprave të tjera në sektorin e energjisë së rinovueshme;



- 4.1.5 Planifikimin, organizimin dhe kontrollin strategjik dhe operativ të sipërmarrjeve në të cilat ka pjesëmarrje, si edhe ofrimin e shërbimeve financiare, tregtare, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, administrative, kontabël dhe teknike në favor të sipërmarrjeve në të cilat zotëron pjesëmarrje;
- 4.1.6 Blerjen, shitjen, shkëmbimin dhe tregtimin e trojeve dhe ndërtimeve civile, bujqësore, urbane, industriale dhe tregtare;
- 4.1.7 Aktivitetin e administrimit të pasurive të paluajtshme, në formën e qiradhënies apo në forma të tjera që do të vlerësohen si të përshtatshme nga Shoqëria;
- 4.1.8 Aktivitete të tjera që nuk janë të përfshira në aktivitetet e mësipërme, të cilat Shoqëria vlerëson të kryejë në respektim të normave ligjore.
- 4.2 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj dhe mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Me qëllim përmbushjen e objektit të veprimtarisë dhe jo kundërshtuar publikut, Shoqëria:
- 4.2.1 Mund të zotërojë pjesëmarrje në shoqëri e sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja;
- 4.2.2 Mund të kryejë operacione industriale, tregtare, financiare, me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që vlerësohen të nevojshme apo të dobishme, përfshirë por pa u kufizuar në dhënien e garancive dhe dorëzaneve në favor të bankave, enteve financuese dhe të tretëve në përgjithësi për detyrimet e veta dhe së të tretëve, kërkimin dhe përfitimin e financimeve dhe huave të çdo lloji, nga banka, ente financuese dhe të tretë në përgjithësi, dhënien e financimeve sipërmarrjeve dhe shoqërive në të cilat zotëron pjesëmarrje, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe veprime të tjera të lidhura me objektin e aktivitetit të saj apo që mundësojnë një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve të veta.

NENI 5 KAPITALI

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 1.220.000 Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga ortakët sipas kontributeve të mëposhtme:
- 5.1.1 Ortaku shoqëria "LO" Srl, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Pordenone-Udine (Itali), me numër regjistrimi 02355900305, me seli në Via Umberto



I, 40, San Daniele del Friuli, Udine, është zotërues i një kuote të barabartë me 610,000 Lekë, e barazvlefshme me 50% të kapitalit të Shoqërisë;

- 5.1.2 Ortaku shoqëria "PAFA" Srl, e regjistruar në Regjistrin e Tregtar të Biella dhe Vercelli (Itali), me numër regjistrimi 02494210020, me seli në Biella (BI), piazza Vittorio Veneto 15, CAP 13900, Itali, është zotërues i një kuote pjesëmarrjeje prej 610,000 Lekë, e barazvlefshme me 50% të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 6.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakëve. Premtimi dhe/ose transferimi i kuotave të Shoqërisë në favor të palëve të treta, në çdo formë, mënyrë apo afat, e drejta e opsionit dhe/ose krijimi i të drejtave të tjera mbi këto kuota i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët e Shoqërisë, e drejtë e cila do të ushtrohet në afatet dhe mënyrat e parashikuara në marrëveshje të veçanta nga palët.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kapitali mund të rritet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë Statut.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në përpjesëtim të drejtë me kuotën që zotërojnë në Shoqëri, në përputhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Kontributet në natyrë do të vlerësohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet ortakëve. Në rast se ortakët nuk bien dakord mbi vlerën e kontributit në natyrë, secili prej tyre mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për emërimin e një eksperti.
- 7.3 Nëse ortakët heqin dorë nga e drejta për të nënshkruar zmadhimin përkatës të kapitalit apo nuk e ushtrojnë këtë të drejtë brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi i kapitalit mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë ose nga palët e treta të interesuara, duke u ruajtur ushtrimi i të drejtës së parablerjes nga ortakët.

NENI 8 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË



- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë Statut. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili ortak në përpjesëtim të drejtë me kuotën e zotëruar në Shoqëri.

NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas legjislacionit shqiptar, këtij Statuti dhe/ose çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij dhe të votojë sipas të drejtave që ka pjesëmarrja e tij në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë i pajisur me autorizim me shkrim.
- 9.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me parashikimet e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori/ët ose ortakët e Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose letërporosi, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për çështjet përkatëse.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i zgjedhur midis të pranishmëve. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.



- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveç sa parashikohet në nenin 9.10 të këtij Statuti, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm, kur ortakët e mbledhur me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve të pranishëm, kur ortakët e mbledhur me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, për çështjet e mëposhtme:
- a) Ndryshimet e statutit;
 - b) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - c) Shpërndarjen e fitimeve;
 - d) Bashkimin, ndarjen, riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë.

NENI 10 ADMINISTRIMI

- 10.1 Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një administrator i vetëm ose nga një Këshill Administrimi i përbërë nga më shumë se një administrator, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Në rastin e emërimit të një Këshilli Administrimi, Asambleja e Përgjithshme do të plotësojë njëkohësisht statutin me rregullimin e kompetencave dhe funksionimit të tij. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet në detyrë ose të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori i Vetëm gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve që ka autorizuar.
- 10.3 Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.



- 10.4 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë Znj. Ledia Beçi, e lindur në Tiranë më 23/06/1974, me dokument identifikimi nr. 033140003, e caktuar në detyrë nga data e këtij akti deri më 31/12/2019.
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë.

NENI 11

VITI FINANCIAR, KONTROLLI FINANCIAR DHE DIVIDENDI

- 11.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 11.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare vjetore, raportet e Administratorëve dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Organi administrues është i detyruar t'i paraqesë për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore.
- 11.3 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.4 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga auditues ligjorë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi i tyre është i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.
- 11.5 Në përputhje me dispozitat e ligjit, Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë. Fitimet do t'iu shpërndahen ortakëve përpjesëtimisht me kuotën që zotërojnë në Shoqëri.

NENI 12

DISPOZITA TË NDRYSHME

- 12.1 Në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi.
- 12.2 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat ligjore, këtë akt dhe marrëveshjet e ortakëve (nëse ka të tilla të lidhura ndërmjet ortakëve). Dispozitat e ligjit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky akt.
- 12.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë, ortakëve dhe personave që tërheqin të drejta, organit administrues dhe Shoqërisë do të gjykohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



12.4 Ky akt hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën italiane dhe në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjes të mundshme ndërmjet dy versioneve gjuhësore të këtij akti, versioni në gjuhën italiane do të mbizotërojë dhe do të jetë i vetmi version ligjërishet detyrues.

Nënshkruar në Biella, më 31.07.2019.

ORTAKËT

Për shoqërinë LO Srl
Z. Massimo Vignuda


LO S.r.l.

Via Umberto I, 40
33038 SAN DANIELE DEL FRIULI (UD)
C.F. e P.IVA: 02355900305

Për shoqërinë PAFA Srl
Z. Ferdinando Botto Poala

PAFA S.R.L.
~~Plaza Vittorio Veneto, 15~~
~~13900 BIELLA~~
c.f. e p.Iva 02494210020

ATTO COSTITUTIVO E STATUTO
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
FREE CO SHPK



ATTO COSTITUTIVO E STATUTO
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
FREE CO SHPK

ARTICOLO 1
DENOMINAZIONE DELLA SOCIETÀ

- 1.1 La denominazione della società è "FREE CO" SHPK (di seguito riferito come "Società").

ARTICOLO 2
SEDE LEGALE

- 2.1 La sede legale della Società è stabilita all'indirizzo: Rr. "Abdi Toptani", Ndërtesa "Torre Drin", Kati 4, Ap. 10, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tirana, Albania.
- 2.2 L'Assemblea Generale può decidere di trasferire la sede della Società in altro luogo. L'organo amministrativo della Società ha la facoltà di istituire e sopprimere filiali e/o uffici di rappresentanza in Albania e all'estero.

ARTICOLO 3
DURATA

- 3.1 La Società svolgerà la sua attività sociale per un indeterminato periodo di tempo.

ARTICOLO 4
OGGETTO SOCIALE

- 4.1 La Società ha come principale oggetto di attività:
- 4.1.1 Il finanziamento, la progettazione, la costruzione, la messa in opera, la gestione, la manutenzione e il trasferimento di impianti per la produzione di energia elettrica da fonti rinnovabili quale acqua, gas, calore, ecc.;
 - 4.1.2 La produzione, la trasmissione, l'acquisto, la vendita, la permuta e il *trading* di energia elettrica, incluse le attività di importazione ed esportazione di energia, prodotti e servizi;
 - 4.1.3 L'attività di finanziamento, l'acquisizione di interessi e partecipazioni in società e imprese, la gestione, la ricerca e l'innovazione, la consulenza e l'assistenza nel settore energetico in generale;
 - 4.1.4 La consulenza, l'elaborazione di progetti relativi a energie rinnovabili nonché la realizzazione e la successiva gestione di tali investimenti, compresa la costruzione e

- gestione di centrali idroelettriche o di altre opere nel settore dell'energia rinnovabile;
- 4.1.5 La pianificazione, l'organizzazione ed il controllo strategico ed operativo delle imprese nelle quali partecipa, nonché la prestazione di servizi finanziari, commerciali, mobiliari e immobiliari, amministrativi, contabili e tecnici a favore delle imprese partecipate;
- 4.1.6 L'acquisto, la vendita, la permuta e la commercializzazione di terreni e fabbricati civili, rustici, urbani, industriali e commerciali;
- 4.1.7 L'attività di gestione e amministrazione di immobili, in forma di locazione o in altre forme ritenute idonee dalla Società;
- 4.1.8 Altre attività, non incluse tra le suddette attività, che la Società ritiene di svolgere, nel rispetto delle norme di legge.
- 4.2 La Società può operare sia in Albania che all'estero e potrà svolgere qualsiasi altra attività connessa, strumentale, affine, complementare o comunque utile per il conseguimento dell'oggetto sociale. Ai fini del perseguimento dell'oggetto sociale e non nei confronti del pubblico, la Società:
- 4.2.1 Può assumere partecipazioni in altre società e imprese, sia Albanesi che straniere;
- 4.2.2 Potrà compiere operazioni industriali, commerciali, finanziarie, mobiliari e immobiliari che sono ritenute necessarie o utili quali, a titolo esemplificativo e non esaustivo, la prestazione di garanzie e fidejussioni a favore di banche, enti creditizi e terzi in generale per obbligazioni proprie e di terzi, la richiesta e l'ottenimento di finanziamenti e mutuo di qualsiasi tipo, da banche, enti creditizi e terzi in generale, la concessione di finanziamenti a imprese e società partecipate, operazioni mobiliari, immobiliari, commerciali e quant'altro collegato all'oggetto sociale o che consente una migliore utilizzazione delle proprie strutture e/o risorse.

ARTICOLO 5 CAPITALE SOCIALE

- 5.1 Il capitale della Società è pari a 1.220.000 Lekë, suddiviso in 2 (due) quote. Il capitale sociale viene interamente sottoscritto dai soci secondo i seguenti contributi:
- 5.1.1 Il socio la società "LO" Srl, iscritta al Registro delle Imprese di Pordenone - Udine, (Italia) al numero d'iscrizione 02355900305, con sede sociale in Via Umberto I, 40, San Daniele del Friuli, Udine, è titolare di una quota di partecipazione pari a 610.000 Lekë, equivalente al 50% del capitale della Società;



3

- 5.1.2 Il socio la società "PAFA" Srl, iscritta al Registro delle Imprese di Biella e Vercelli, (Italia) al numero d'iscrizione 02494210020, con sede sociale in Biella (BI), piazza Vittorio Veneto 15, CAP 13900, Italia, è titolare di una quota di partecipazione pari a 610.000 Lekë, equivalente al 50% del capitale della Società.

ARTICOLO 6 TRASFERIMENTO DELLE QUOTE


- 6.1 Le quote della Società potranno liberamente trasferirsi tra i soci. La promessa e/o il trasferimento delle quote della Società a favore di terzi, in qualsiasi forma, modalità o termine, il diritto d'opzione e/o la costituzione di altri diritti su tali quote è soggetto al diritto di prelazione da parte dei soci della Società, da esercitarsi nei termini e con le modalità previste in separati accordi dalle parti.

ARTICOLO 7 AUMENTO DEL CAPITALE SOCIALE

- 7.1 Il capitale sociale potrà essere aumentato in qualsiasi momento previa delibera dell'Assemblea Generale adottata con la maggioranza qualificata prevista nel presente Statuto.
- 7.2 In caso di aumento di capitale sociale, tutti i soci avranno il diritto a sottoscrivere l'aumento di capitale *pro quota*, in base a quanto disposto dall'Assemblea Generale. I contributi in natura saranno valutati di comune accordo scritto tra i soci. Nel caso i soci non concordassero sul valore del contributo in natura, ognuno di essi potrà rivolgersi al tribunale competente per la nomina di un esperto.
- 7.3 Qualora i soci rinuncino al diritto di sottoscrivere il rispettivo aumento di capitale oppure non esercitassero tale diritto nei termini e secondo le modalità stabilite nella delibera dell'Assemblea Generale, l'aumento di capitale potrà sottoscriversi dagli altri soci oppure dai terzi interessati, fatto salvo l'esercizio del diritto di prelazione dai soci.

ARTICOLO 8 DIMINUZIONE DEL CAPITALE SOCIALE

- 8.1 La Società può diminuire il capitale sociale previa delibera dell'Assemblea Generale adottata con la maggioranza qualificata prevista nel presente Statuto. In ogni caso il capitale sociale non potrà essere diminuito sotto il minimo previsto dalla legge.
- 8.2 La riduzione del capitale è sopportata da ciascun socio proporzionalmente alla quota detenuta in Società.

 4

ARTICOLO 9
ASSEMBLEA GENERALE

- 9.1 L'Assemblea Generale delibera su tutte le questioni per le quali è competente secondo la legislazione albanese, il presente Statuto e/o ogni altro accordo tra i soci della Società.
- 9.2 Ogni socio ha il diritto di partecipare nelle riunioni dell'Assemblea Generale, esprimere la propria volontà e votare in proporzione ai diritti della propria partecipazione sociale.
- 9.3 Ogni socio potrà farsi rappresentare da un altro socio ovvero da un terzo munito di delega scritta.
- 9.4 Le riunioni dell'Assemblea Generale potranno svolgersi entro il territorio della Repubblica d'Albania o all'estero. I soci oppure i rappresentanti autorizzati possono partecipare nella riunione dell'Assemblea Generale tramite mezzi elettronici, inclusa la teleconferenza e/o videoconferenza, in conformità con le disposizioni della legge sugli imprenditori e le società commerciali e la legge sulle comunicazioni elettroniche. L'Assemblea si considera riunita nel luogo in cui si trovano il Presidente e il Segretario della riunione, al fine di redigere e sottoscrivere l'apposito verbale.
- 9.5 L'Assemblea Generale è convocata dall'amministratore/i o dai soci, in conformità con le previsioni di legge, e ogni volta che la convocazione è obbligatoria ai sensi di legge. La convocazione dell'Assemblea Generale deve avvenire tramite avviso scritto o lettera raccomandata, almeno 7 (sette) giorni prima della data fissata per la riunione. L'avviso di convocazione deve contenere l'ordine del giorno, il luogo, la data e l'ora della riunione. L'Assemblea Generale sarà regolarmente riunita nel caso in cui, indipendentemente dal rispetto delle predette formalità, tutti i soci oppure i loro rappresentanti concordano sull'ordine del giorno e decidono di deliberare sulle rispettive questioni.
- 9.6 Le riunioni dell'Assemblea Generale sono presiedute dal Presidente eletto tra i presenti. L'Assemblea Generale nomina tra i presenti il Segretario per ogni riunione.
- 9.7 Le delibere dell'Assemblea Generale sono in forma scritta e sottoscritte dal Presidente e dal segretario. Su richiesta dei soci, le delibere devono includere anche le dichiarazioni o le osservazioni dei soci.
- 9.8 L'Assemblea Generale viene convocata almeno una volta all'anno, entro 6 (sei) mesi dalla chiusura dell'esercizio sociale.
- 9.9 L'Assemblea Generale, salvo quanto disposto all'art. 9.10 del presente Statuto, delibera con



il voto favorevole della maggioranza dei soci presenti, quando i soci riuniti con diritto di voto rappresentano più del 30% (trenta per cento) del capitale sociale.

- 9.10 L'Assemblea Generale delibera con $\frac{3}{4}$ dei voti dei soci presenti, quando i soci riuniti con diritto di voto rappresentano più del 50% (cinquanta per cento) del capitale sociale, nelle seguenti materie:
- a) Modifiche statutarie;
 - b) Aumento e diminuzione del capitale sociale;
 - c) Distribuzione dell'utile;
 - d) La fusione, la scissione, la riorganizzazione, lo scioglimento e la liquidazione della Società.

ARTICOLO 10 AMMINISTRAZIONE

- 10.1 La Società sarà amministrata e rappresentata da un amministratore unico o da un Consiglio di Amministrazione composto da più amministratori, eletto dall'Assemblea Generale per un periodo massimo di 5 (cinque) anni. Nel caso di nomina di un Consiglio di Amministrazione, l'Assemblea Generale integrerà contestualmente lo statuto con la disciplina inerente le sue competenze ed il suo funzionamento. L'Amministratore Unico potrà essere rieletto o rimosso dalla carica dall'Assemblea Generale.
- 10.2 L'Amministratore Unico gode pieni diritti in merito all'amministrazione della Società e potrà compiere tutti gli atti di ordinaria e straordinaria amministrazione. L'amministratore è responsabile per gli atti compiuti durante l'amministrazione della Società e potrà delegare terzi per compiere determinati atti, in nome e per conto della Società. In ogni caso, l'amministratore sarà tenuto responsabile dell'attività dei terzi delegati.
- 10.3 L'Amministratore Unico agisce nel rispetto delle politiche commerciali stabilite dall'Assemblea Generale. L'Amministratore opererà in ogni momento solo nel miglior interesse della Società.
- 10.4 Il primo amministratore della Società sarà la Sig.ra Ledia Beçi, nata a Tirana il 23/06/1974, con documento d'identità n. 033140003, nominata in carica dalla data del presente atto sino al 31/12/2019.
- 10.5 L'Assemblea Generale determina il compenso dell'organo amministrativo della Società.

ARTICOLO 11 ANNO FINANZIARIO, CONTROLLO FINANZIARIO E DIVIDENDI

- 11.1 L'anno finanziario della Società inizia il 1 gennaio e termina il 31 dicembre di ogni anno.
- 11.2 Il bilancio annuale, i prospetti contabili annuali, le relazioni degli Amministratori e dei revisori legali (ove nominati) verranno approvati dall'Assemblea Generale. L'organo amministrativo è obbligato a presentare per approvazione all'Assemblea Generale la relazione sull'andamento dell'attività sociale e i prospetti contabili annuali.
- 11.3 I documenti riguardanti l'anno finanziario sono soggetti all'approvazione dell'Assemblea Generale entro 6 (sei) mesi dalla chiusura dell'anno finanziario.
- 11.4 Il controllo finanziario della Società viene effettuato dai revisori legali in conformità con la legislazione Albanese in vigore. L'Assemblea Generale nominerà uno o più revisori legali in tutti i casi quando la nomina sia necessaria oppure richiesta per legge.
- 11.5 In conformità con le disposizioni di legge, l'Assemblea Generale decide sulla distribuzione del dividendo in base al risultato finanziario della Società. I dividendi verranno distribuiti ai soci *pro quota*.

ARTICOLO 12 MISCELLANEE

- 12.1 In caso di scioglimento e liquidazione della Società si applicheranno le disposizioni di legge in vigore.
- 12.2 La Società svolgerà la sua attività in conformità con le norme di legge, il presente atto e i patti parasociali (ove stipulati tra i soci). Le disposizioni della legislazione albanese in materia di società commerciali saranno applicate nei casi non previsti dal presente atto.
- 12.3 Le controversie che possono sorgere tra la Società, i soci e gli aventi causa, l'organo di amministrazione e la Società saranno devolute alla giurisdizione esclusiva del Tribunale Distrettuale di Tirana.
- 12.4 Il presente atto viene redatto e sottoscritto in 4 (quattro) esemplari in lingua italiana e in 4 (quattro) esemplari in lingua albanese. In caso di eventuali discrepanze tra le due versioni linguistiche del presente atto, la versione in lingua italiana prevarrà e sarà l'unica legalmente vincolante.

Sottoscritto in Biella, il 31.07.2019.

I SOCI



7

Per la società LO Srl
Sig. Massimo Vignuda

LO S.r.l.

Via Umberto I, 40
33038 SAN DANIELE DEL FRIULI (UD)
C.F. e P.IVA: 02355900305

Per la società PAFA Srl
Sig. Ferdinando Botto Poala

PAFA S.R.L.

Plaza Vittorio Veneto, 15
13900 BIELLA

c.f. e p.iva 02494210020